



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.469-2/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr. 469/2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar** kërkesa Anr.469-2/2021 e datës 18.02.2021, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimit të PZAP-it, Anr.469/2021 i datës 16.02.2021, me të cilin ju është shqiptuar dënimi më gjohë në lartësi prej 500.00 euro, në emër të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, pasi që është vendos për çështjen e njëjtën, me rastin e marrjes së vendimit për ankesën Anr.454/2021, me vendimin e PZAP-it, Anr. 401/2021 i datës 15.02.2021.

## A r s y e t i m

Paneli me vendimin Anr.469/2021 i datës 16.02.2021, subjektit ankues i ka shqiptuar dënim më gjohë në lartësi prej 500.00 euro, në emër të thyerjes së heshtjes zgjedhore.

PZAP-i, me datë 18.02.2021, ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.469/2021 nga subjekti politik Partia Demokratik e Kosovës, me të cilën pretendohet se me datë 17.02.2021 nga PZAP kanë pranuar vendimin Anr.469/2021 i datës 16.02.2021, për të cilin PZAP ka shqiptuar gjohë prej 500 eurove, edhe pse ishte përsëritje e ankesës 454/21, për të cilën janë shqiptuar gjoha në grupe Anr.401, A.nr.402, A.nr.403 etj, në vlerë 10,500.00 euro.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Kërkesa për Rishqyrtim dhe anulimin e të vendimit Anr. 469-2/2021 i datës 16.02.2021, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesa Anr.469/2021 e datës 18.02.2021 për rishqyrtimin e vendimit rrjedh se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të

vërtetojë pretendimet e parashtruara në apel- kërkesë, kjo për faktin se PZAP-i pas shqyrtimit të kërkesës erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë me përsëritje të ankesës ashtu siç pretendohet në kërkesën për rishqyrtimin e Vendimit A.Nr.469/2021 të datës 16.02.2021, ngase nga Vendimi A.nr 469/2021 i datës 16.02.2021 është vërtetuar se sekretari i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës Trim Sylja ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë një postim në rrjetin social Facebook me tekst duke bërë thirrje për ta votuar numrin e subjektit politik PDK, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 36, paragrafi 1, pika b) të LZP-së.

Ndërsa nga vendimi A.nr.401/2021 i datës 15.02.2021 ku është e përfshirë ankesa A.nr.454/2021 është vërtetuar se po i njëjti person pra sekretari i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës Trim Sylja ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë një postim tjetër në këtë rast duke e ndërruar “foton e coverit” të rrjetit social Facebook në të cilin shihet numri i subjektit politik PDK me të cilin ka garuar në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021 veprim ky i cili po ashtu përbën shkelje të dispozitës ligjore nga neni 36, paragrafi 1, pika b) të LZP-së.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura vendimi i kontestuar me rishikim, rezulton të jetë i drejtë, i ndërtuar mbi fakte, prova dhe i mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118.4, me të cilin përcaktohet se: *“Mund të apelohe vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjetedy (72) orëve pas paraqitjes së apelit”.*

Në rastin konkret subjekti politik Partia Demokratik e Kosovës, kërkesën për rishikim të vendimit nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bindte panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që apelin-kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 par.4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
Anr.469-2/2021 më datë 19.02.2021

**Kryesues i Panelit**  
Adnan Konushevc



**Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.**